



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.10.2018, ora 10.00....

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 17.07.2018 dhe 12.09.2018.
2. Miratimi i kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 15 tetor - 2 nëntor 2018.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri -Kosovë, alokimet e vitit 2016”.
5. Të tjera.

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodjana Spahiu, Sadri Abazi, Eglantina Gjermani, Andrea Marto.

Mungojnë:

Genc Pollo, Aldo Bumci, Vangjel Dule, Taulant Balla, Grida Duma, Jorida Tabaku, Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj.

Të ftuar:

Genti Cakaj - Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi – Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Integrimin European.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të datave 17.07.2018 dhe 12.09.2018; miratimin e kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 15 tetor - 2 nëntor 2018; shqyrtimin e projektligjit “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”; shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri -Kosovë, alokimet e vitit 2016”; si dhe çështje të tjera.

Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

A ka ndonjë vërejtje për procesverbalet e mbledhjeve të kaluara? Nuk ka.

Miratoohen procesverbalet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, me miratimin e kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 15 tetor - 2 nëntor 2018, të cilën ua kemi dërguar me email të gjithë anëtarëve të komisionit.

A ka ndonjë vërejtje apo sugjerim për kalendarin? Nuk ka.

A jeni dakord me kalendarin e komisionit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet kalendari për periudhën 15 tetor - 2 nëntor 2018.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, me shqyrtimin e projektligjit “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Për të prezantuar këtë projektligj kemi të ftuar nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Genti Cakaj, zëvendësministër, dhe zonjën Daniela Çekani, drejtoreshë në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Mirë se keni ardhur!

Atëherë, shkurtimisht nga ju zoti Cakaj, si përfaqësues i ministrisë, do të dëgjojmë se çfarë përmban kjo marrëveshje dhe më pas do të kalojmë në pyetje dhe diskutime.

Genti Cakaj - Qëllimi final i projektaktit është ratifikimi i marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Europian për alokimet buxhetore të fondeve IPA për vitin 2016.

Përmbajtja e kësaj marrëveshjeje është derivacioni i drejtpërdrejt i paketës për bashkëpunim ndërkufitar 2014-2020. Ndërkaq, përmbajtja specifike që diskutohet sot me ju është alokimi i buxhetit për vitin 2016.

Për t'ju kursyer kohën nuk po e lexoj dokumentin, por do të fokusohem vetëm në tre elemente kryesore, që besoj se meritojnë vëmendjen tuaj:

Së pari, është baza ligjore për një procedim të tillë.

Marrëveshja e financimit është miratuar nga ana e Këshillit të Ministrave me vendimin nr. 249, datë 29.03.2017. Po ashtu, marrëveshja për palën shqiptare është nënshkruar në datën 26.07.2017 nga ana e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe pala kosovare.

Së dyti, është aspekti financiar i marrëveshjes. Këtu po flasim për një shumë të përgjithshme prej 1 milion e 411 mijë e 765 eurosh në tërësi, që do të afektojnë zonat kufitare të Shqipërisë dhe Kosovës.

Kontributi i BE-së është 1 milion e 200 mijë euro, ndërsa shuma tjetër e mbetur është një bashkim financiar i Kosovës dhe i Shqipërisë.

Komponenti i tretë, që duhet të marrë vëmendjen tuaj, është efekti përmbajtjesor në këtë marrëveshje.

Zonat që do të përfitojnë nga kjo marrëveshje janë qarku i Kukësit dhe qarku i Lezhës, në 6 bashki në total, kurse në Kosovë përfshihet rajoni ekonomik perëndimor dhe rajoni ekonomik jugor në bashkësi.

Sipas vlerësimeve të komisionit, 76% e zonave të afektuara prej këtyre fondeve prekin territorin e Kosovës, duke marrë në konsideratë edhe nevojat e komunitetit, ndërsa pjesa tjetër prek Shqipërinë. Kaq për sa i përket domosdoshmërisë së ratifikimit të kësaj marrëveshjeje financiare ndërmjet Republikës së Kosovës, Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Cakaj!

Atëherë, sipas Rregullores dhe traditës që ne kemi si komision për këtë projektligj, komisioni ynë është komision për dhënie mendimi, kështu që ne kemi përgatitur shënimet e

Kuvendit në një relacion. Unë po lexoj vetëm konkluzionin e relacionit që do të miratojmë, për t'ia dërguar më pas këtë relacion komisionit përgjegjës. Duke ju kursyer titullin e gjatë të projektligjit konkluzioni përfundimtar është: “Ky projektligj nuk synon të përafrojë ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së.” Për këtë arsye ne nuk kemi ndonjë objeksion të rëndësishëm për t'ia sugjeruar komisionit përgjegjës. Pra, kjo është përmbajtja thelbësore e relacionit.

A ka ndonjë pyetje?

Arben Kamami – Kam dy pyetje.

Kuvendi i Shqipërisë, në vijim të miratimit të “Axhendës 2030” për zhvillim të qëndrueshëm nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës për Kombet e Bashkuara, ka miratuar rezolutën për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara. Në këtë Axhendë parashikohet monitorimi i zbatimit të këtyre objektivave dhe për këtë është kërkuar nga Kryetari i Kuvendit që në relacionet e projektligjit, për një periudhë transitore, deri në miratimin e Rregullores, në ndryshimin e nenit 68 të përfshihet edhe një zë, i cili duhet të paraqesë secilën nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm që synohen të përmirësohen. Duke lexuar relacionin e projektligjeve në diskutim vërehet se një zë i tillë nuk rezulton i pasqyruar. Më lejoni t'ju pyes: cila është arsyeja që kjo gjë nuk është përfshirë në “Axhendën 2030”? Cilat janë objektivat që këto marrëveshje kontribuojnë për t'u përmirësuar? Në rast se nuk keni një përgjigje në këtë moment, do t'ju lutesha të na i dërgoni.

Genti Cakaj – Patjetër që do të përgjigjem, por nuk mund të jem konciz në mënyrë maksimale.

Procesi e parë i fondeve IPA është asistencë financiare e paraanëtarimit, që vjen nga Bashkimit Europian dhe jo domosdoshmërisht është e ndërlidhur me çështjen e objektivave strategjike për vitin 2030. Ndërkaq, kontributi se cilat janë fushat që afekton fondi në fjalë mund të jenë të ndërlidhura praktikisht me objektivat e “Axhendës 2030”. Nëpërmjet këtij fondi janë tri fusha, në të cilat do të investohet.

Së pari, nxitja e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Së dyti, mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimet ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.

Së treti, nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike e punonjësve dhe përfshirja sociale e kulturore ndërmjet dy kaheve të kufirit.

Pra, këto janë tri fushat që do të afektohet drejtpërdrejtë fondi në fjalë.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Po, zonja Gjermani ka fjalën.

Eglantina Gjermani – Unë do të vazhdoj të insistoј në atë që tha kolegu, për faktin se të tria këto fusha apo prioritet, që ju keni përzgjedhur, konvergohen me një sërë objektivash të zhvillimit të qëndrueshëm, thjesht duhet t’i vëmë në dukje. Patjetër që ato kanë lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe politikat miqësore ndaj tij, partneritetin, zhvillimin afatgjatë të qëndrueshëm dhe përfshirës, kështu që thjesht duhet të evidentohen, sepse jam e bindur, edhe nga relacioni që kam lexuar, që konvergohen ose përputhen me një sërë objektivash. Meqenëse ne, si deputetë, e kemi marrë atë rezolutë dhe kemi rënë dakord që do të monitorojmë zbatimin e saj, duam që të shikojmë konkretisht se cilat janë këta objektiva që përputhen me prioritet e kësaj projektmarrëveshjeje.

Genti Cakaj - Unë thashë që praktikisht janë *compatible*, por si procese formalisht janë të ndara.

Bledar Çuçi – A biem dakord, meqenëse ky nuk është një detyrim ligjor dhe drejtpërdrejtë yni, që ta shikojmë marrëveshjen nëse ka pjesë që duhet të përputhen. E gjej me vend vërejtjen e dy kolegëve, që ne si komision t’i çojmë një letër kujtese qeverisë, ndoshta ia dërgojmë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, që të gjitha projektligjet që do të vijnë në Kuvend të përmbajnë edhe sqarimin e lidhjes së objektivave të vitit 2030, të Kombeve të Bashkuara, me përputhshmërinë e agjendës që ka Shqipëria në lidhje me këtë. A biem dakord? Dakord të gjithë. Atëherë do të bëjmë një letër në emër të komisionit, për t’i kujtuar këtë gjë, duke marrë shkas edhe nga diskutimet që u zhvilluan këtu.

A ka pyetje të tjera për këtë projektligj? Nuk ka.

Hedhim në votim projektligjin. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

SEKRETAR

Fatmir Velaj

Sekretare e komisionit)
Valbona Noli (Collaku

Përgjegjëse e Sektorit Redaktorëve
Euzheni Pengili